

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dep. Dop. Dep.	DPKI
Nr. Faq. Er. Str. Nr. Page	03
Pr. Prot. Er. Prot. Prot. No.	06-02/05/23
Data Datum Date	06-01-2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE
 THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 04.01.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-4188//22, për zyrtarin e lartë z. Besnik Boletini, Anëtar i Bordit në Radiotelevizionin e Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pas pranimit të denoncimit nga jashtë me pretendimin e shkruar si vijon; *“Besnik Boletini është emëruar Anëtar i Bordit në Radiotelevizionin e Kosovës me datë 06.12.2021. Në Formularin e Deklarimit të Pasurisë sipas raportuesit vazhdon të punojë si gazetar hulumtues qendrën kulturore për gazetari hulumtuese “Çohu” prej datës 01.11.2011. Po ashtu edhe në profilin e tij në facebook shkruan se Besnik Boletini është gazetar në këtë organizatë”* thuhet në pretendim dhe vazhdon;

“Sipas Ligjit nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, konkretisht në nenin 27 pika 1.6 dhe 1.8 shprehimisht thuhet;

1.6. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy (2) vitet e fundit.

1.8. pronarët apo bashkëpronarët e medieve transmetuese ose bizneseve reklamuese si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj është organizuar një takim në Agjenci, me këtë rast zyrtari i lartë është njoftuar me pretendimin e ngritur për konflikt interesi.

Agjencia lidhur me këtë rast ka kërkuar dhe pranuar dokumentacionin relevant nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia ofron konstatimet si në vijim;

Zyrtari i lartë z. Besnik Boletini, është i punësuar në Organizatën Joqeveritare Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – Çohu, në pozitën Hulumtues, kjo dëshmohet me kontratë pune e lidhur ndërmjet përfaqësuesit të autorizuar dhe punëmarrësit.

Bazuar në nenin 3 të statutin e Organizatës joqeveritare Çohu, qëllimi i themelimit të kësaj Organizate Joqeveritare është luftimi i korrupsionit, demokratizimit të shoqërisë, përparimit të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, përparimit të praktikës demokratike dhe shoqërisë civile si dhe luftimit të çdo dukurie demokratike.

Në nenin 14 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit shprehimisht thuhet;

Anëtarësia në organizata joqeveritare

1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.

2. Organizata joqeveritare sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitojë fonde nga institucioni ku ushtron detyrën zyrtari që është anëtar i organit drejtues në këtë organizatë.

Ushtrimi i funksioni Anëtar i Bordit në Radiotelevizionin e Kosovës dhe njëkohësisht Hulumtues në Organizatën për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – Çohu, nuk është në kundërshtim me nenin 14 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, kjo për faktin se funksioni hulumtues në këtë organizatë joqeveritare nuk konsiderohet funksion drejtues.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 20, paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilën shprehimisht është përcaktuar se: “*Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës*”, Agjencia ka pasur në konsideratë nenin 12 [Pamundësia për të qenë anëtarë i anëtar i Bordit të RTK-së] konkretisht paragrafi (1.6 dhe 1.8) të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, me të cilin është përcaktuar se: “1. Anëtar i Bordit të RTK-së nuk mund të jenë:

1.6. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy (2) vitet e fundit;

1.8. pronarët apo bashkëpronarët e medieeve transmetuese ose bizneseve reklamuese si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media;

Mirëpo, kufizimi (eventual) si më lartë nuk rrjedh nga dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, por nga Ligji Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës si ligj i veçantë (*lex specialis*), e si i tillë interpretohet dhe zbatohet nga komisioni përkatësi Kuvendit të Republikës së Kosovës.


Dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisive ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Ky Vendim i referohet vetëm situatës konkrete për konflikt të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe nuk trajton çështje tjera.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtore Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

